Tritoli në derën e banesës, zbardhet dëshmia e gjyqtarit në policinë e Shkodrës. Dalin detaje për autorin

Senad Nikshiqi | 28 Prill, 2024 11:05



Madhësia e tekstit:

Një sasi tritoli shpërtheu në orët e para të mëngjesit në banesës e shtetasit Tonin Sterkaj, me detyrë gjyqtarë në gjykatën e shkallës së parë në Shkodër. Ngjarja ndodhi rreth orës 3:13 minuta në lagjen "Tom Kola" bën të ditur policia vendore e Shkodrës.

Sasia e tritolit është vendosur tek porta e oborrit të banesës së gjyqtarit Sterkaj vijon më tej policia teksa janë shkaktuar vetëm dëme materiale. Një person futet në rrugicë dhe ecën në këmbë dhe pasi mbërrin tek dera e banesës së gjyqtarit Sterkaj vendos lëndën plasëse dhe më pas largohet me shpejtësi dhe pas pak sekondash ndodh edhe shpërthimi.

Sponsored Links

Autori është i maskuar në fytyrë dhe deri më tani nuk është identifikuar nga efektivët. Ndërkohë gjyqtari Sterkaj ka qenë brenda banesës kur ka ndodhur shpërthimi së bashku me familjen e tij.

Pasi ka dëguar zhurmën ka dalë në ballkon, por pa e ditur se tritoli ishte vendosur në derën e tij. Një komshi e ka njoftuar dhe më pas ka vërejtur se ngjarja lidhet me të. Gjyqtari Sterkaj ka dhënë një dëshmi në policinë e Shkodrës duke thënë se dyshon se kjo ngjarje lidhet me detyrën e tij si gjyqtarë në gjykatën e Shkodrës por pa e patur të qartë se për cilin rast mund të bëhet fjalë konkretisht.

Policia vendore e Shkodrës është duke hetuar dhe sipas burimeve ka disa të dhëna që mund të çojnë në zbulimin e autorit të vendosjes së tritolit i cili sipas efektivëve është një person që mendohet se është paguar nga dikush tjetër që ka patur çështje në gjykatë. Policia vijon kontrollet në zonë dhe po ashtu grupi hetimor po vijon vepримet në vendngjiarje për sigurimin e provave me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit.

Vendosja e lëndës plasëse në derën e oborrit të banesës së gjyqtarit Tonin Sterkaj dyshohet se është një mesazh kërcënues ndaj tij. Tonin Sterkaj ushtron prej shumë vitesh detyrën e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë në Shkodër ndërsa pak më përpara pati një periudhë dy vjeçare që ishte në gjykatën e apelit të Shkodrës dhe pas mbylljes së kësaj të fundit u rikthye në shkallën e parë duke vijuar detyrën e tij.

SONDAZH

Në përballjen e opozitës me kryebashkiakun Veliaj, kë përkrahni?

- Opozitën
- Erion Veliajn
- Jam neutral

Voto

Rezultatet

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Unmute

Në pak orë distancë, regjistrohen dy lëkundje tërmeti në Kretë
29 Prill, 2024

Aksident i rëndë në Pogradec-Qafë Thanë/ "Benz"-i në korsinë e gabuar përplaset me "Citroen"-in, humb jetën i moshuari
29 Prill, 2024

TaboolaFeed

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Goditi me sende të forta në kokë 55-vjeçarin në Korçë, shoqërohet autori (EMRI)
28 Prill, 2024

Autori hyri në bar, nxori armën dhe...// Sherr mes shqiptarëve dhe rumunëve në Itali, plagoset edhe një kliente në lokal
28 Prill, 2024

Shqiptari vret pronarin e lokalit në Gjermani, u kthye ne vendin e ngjarjes dhe...
28 Prill, 2024

Pinë alkool dhe rrahin të miturin, nisin hetimet për tre të rinjtë në Elbasan, kamarieri dhe pronari i lokalit...
28 Prill, 2024

Kanosi të miturit ditën e djeshme në Lungomare, policia jep detaje: 30-vjeçari vuan nga sëmundje mendore
28 Prill, 2024

"Fast and Furious" në rrugët e Shqipërisë/ 18 automjete manovra të rreziksheme në aksin Tiranë-Elbasan, policia merr masa për drejtuesit
28 Prill, 2024

KATEGORIA VIDEO

Pas sulmit me 7 anëtarë të saj të vrarë, World Central Kitchen rinis operacionet e saj humanitare në Gaza
29 Prill, 2024

Tirana jashtë "Final Four", Partizani triumfon në derbi, vendos dopieta e Maguette
28 Prill, 2024

Video/ Atalanta thyen Empolin, barazim me gola mes Napolit dhe Romës
28 Prill, 2024

VIDEO/ Nga një gol për seciliën pjesë, City nuk has asnjë problem ndaj Nottingham
28 Prill, 2024

VIDEO/ Interi shkëlqen ndaj Torinos, zikaltërit triumfojnë në ditën e festës së titullit
28 Prill, 2024

Investigimi i RAI 3/ Meloni i del në mbrojtje Ramës: U linçua pse po ndihmon Italinë! T'i dërgojmë solidaritetin tonë kryeministrit shqiptar!
28 Prill, 2024

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kërko ketu

LAJMET E FUNDIT

Pas sulmit me 7 anëtarë të saj të vrarë, World Central Kitchen rinis operacionet e saj humanitare në Gaza
29 Prill, 2024

Tirana jashtë "Final Four", Partizani triumfon në derbi, vendos dopieta e Maguette
28 Prill, 2024

Video/ Atalanta thyen Empolin, barazim me gola mes Napolit dhe Romës
28 Prill, 2024

VIDEO/ Nga një gol për seciliën pjesë, City nuk has asnjë problem ndaj Nottingham
28 Prill, 2024

VIDEO/ Interi shkëlqen ndaj Torinos, zikaltërit triumfojnë në ditën e festës së titullit
28 Prill, 2024

Investigimi i RAI 3/ Meloni i del në mbrojtje Ramës: U linçua pse po ndihmon Italinë! T'i dërgojmë solidaritetin tonë kryeministrit shqiptar!
28 Prill, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.